

SHENJAT VITALE DHE SIGURIA E PACIENTIT

1. Pulsi quhet normal kur është:

- a) Me rrahje shumë të vogla
- b) I fortë dhe me ndërprerje të rregullta
- c) Të jep në gishtërinj ndjesinë e një fije që zhduket shumë lehtë
- d) Me një amplitudë të shtuar

2. Aritmia është:

- a) Një puls me ritëm të çrregullt
- b) Koha ndërmjet dy rrahjeve është e njëjtë
- c) Pulsi është i fortë dhe me ndërprerje të rregullta
- d) Shpejtësia e punës së zemrës është nën 60 rrahje/min.

3. Ulja e shpejtësisë së pulsit nën 60 rrahje/minut quhet:

- a) Takipne
- b) Takikardi
- c) Bradipne
- d) Bradikardi

4. Krijta e temperaturës trupore mbi normalen quhet:

- a) Hipotension
- b) Hypertension
- c) Hipotermi
- d) Hipertermi

5. Presioni sistolik është:

- a) Presioni i gjakut që ndodh si rezultat i kontraktimit të ventrikulit të majtë dhe nxjerrjes së gjakut në qarkullimin e madh
- b) Presioni kur ventrikuli është në pushim
- c) Presion gjaku jo normal, i ulët
- d) Presion gjaku jo normal, i lartë

6. Hipertensioni është:

- a) Presion gjaku jo normal, i ulët, kur presioni sistolik është nën 90 mmHg
- b) Presion gjaku jo normal, i lartë kur presioni sistolik është >140 mmHg dhe ose 90 mmHg presioni diastolik
- c) Presion gjaku normal, kur presioni sistolik është 120 mmHg
- d) Presion gjaku jo normal, i ulët kur presioni sistolik është nën 100 mmHg

7. Sistola është periudha e kohës kur ventrikulat e zemrës janë:

- a) Të kontraktuara
- b) Të relaksuara
- c) A+B
- d) Asnjëra prej tyre

8. Presioni i gjakut mund të matet direct ose indirect. Matja direkte nënkupton:

- a) Metodën askultative
- b) Metodën palpuese
- c) Futjen e një kateteri, në brendësi të arteries brakiale, radiale ose femorale
- d) Metodën flush

9. Pulsu temporal:

- a) Preket anash qafës, poshtë lobit të veshit
- b) Preket mbi kockën e këmbës
- c) Preket në mes të hapësirës antekubitale (para bërrylit)
- d) Preket aty ku kalon arteria temporale, mbi kockën temporal të kokës

10. Pulsu karotid:

- a) Preket anash qafës, poshtë lobit të veshit, aty ku kalon arteria karotide, ndërmjet trakesë dhe muskulit sternokleidomastoid
- b) Preket aty ku kalon arteria femorale, përgjatë ligamentit inguinal
- c) Preket aty ku kalon arteria popliteale prapa gjurit
- d) Preket mbi kockën e këmbës, aty ku kalon arteria dorsalis pedis

11. Pulsu bracial:

- a) Preket aty ku kalon arteria radiale, përgjatë kockës radiale
- b) Preket aty ku kalon arteria femorale, përgjatë ligamentit inguinal
- c) Preket në mes të hapësirës antekubitale (para bërrylit)
- d) Preket mbi kockën e këmbës, aty ku kalon arteria dorsalis pedis

12. Pulsu radial:

- a) Preket aty ku kalon arteria temporale, mbi kockën temporal të kokës
- b) Preket anash qafës, poshtë lobit të veshit, aty ku kalon arteria karotide
- c) Preket aty ku kalon arteria femorale, përgjatë ligamentit inguinal
- d) Preket aty ku kalon arteria radiale, përgjatë kockës radiale, në pjesën e brendshme të kycit, në anë të gishtit të madh

13. Pulsu femoral:

- a) Preket në sipërfaqen mediale të kaviļjes

- b) Preket aty ku kalon arteria femorale, përgjatë ligamentit inguinal
- c) Preket në mes të hapësirës antekubitale
- d) Preket aty ku kalon arteria temporale, mbi kockën temporale të kokës\

14. Pulsi popliteal:

- a) Preket në mes të hapësirës antekubitale (para bërrylit)
- b) Preket anash qafës, poshtë lobit të veshit
- c) Preket aty ku kalon arteria popliteale prapa gjurit
- d) Preket aty ku kalon arteria temporale, mbi kockën temporale të kokës

15. Pulsi posterior tibial:

- a) Preket në sipërfaqen mediale të kavaljes, aty ku kalon arteria tibiale posteriore, prapa maleolës mediale
- b) Preket aty ku kalon arteria femorale, përgjatë ligamentit inguinal
- c) Në apex të zemrës, në anën e majtë të kraharorit
- d) Preket aty ku kalon arteria temporale, mbi kockën temporale të kokës

16. Pulsi Pedal (dorsalis pedis):

- a) Preket aty ku kalon arteria femorale, përgjatë ligamentit inguinal
- b) Preket në apex të zemrës, në anën e majtë të kraharorit
- c) Preket mbi kockën e këmbës, aty ku kalon arteria dorsalis pedis
- d) Preket aty ku kalon arteria temporale, mbi kockën temporale të kokës

17. Bradipnea është:

- a) Frymëmarrje jo normale e ngadaltë (tek të rriturit zakonisht është nën 12 f/min)
- b) Frymëmarrje jo normale e shpejtë respiratore (tek të rriturit zakonisht mbi 20 f/min)
- c) Mungesë respiracioni, shpesh përshkruhet në bazë të gjatësisë kohore pa respiracion
- d) Një inspiracion me zhurmë të ashpër që ngjan si klithmë

18. Rritja e shpejtësisë së pulsit mbi 100 rrahje/min quhet:

- a) Takipne
- b) Takikardi
- c) Bradipne
- d) Bradikardi

19. Cili nga vendet e matjes së temperaturës trupore është më pak i sakti:

- a) Rektale
- b) Orale
- c) Aksilare
- d) Matja në vesh

20. Një mënyrë që përshkruan volumin apo cilësinë e pulsit është përdorimi i numrave.

Përshkrimi i volumit të pulsit është nga:

- a) 1 në 4+
- b) -1 në 3
- c) 0 në 3+
- d) -1 në 3

21. Frymëmarrja mesatare tek paradoloshentët është:

- a) 6-10
- b) 10-18
- c) 20-40
- d) 40-60

22. Hipotension kemi në ato raste kur:

- a) Presioni sistolik është 140 mmHg dhe diastolik 90 mmHg
- b) Presioni sistolik është <90 mmHg dhe diastolic më < 60 mmHg
- c) Presioni sistolik është 120 mmHg dhe diastolic 80 mmHg
- d) Presioni sistolik është 180 mmHg dhe diastolic 100 mmHg

23. Kufiri i një termometri varion nga:

- a) 26-40 gradë celcius
- b) 34-40.2 gradë celcius
- c) 34-42.2 gradë celcius
- d) 34-39.2 gradë celcius

24. Ortopnea është:

- a) Frymëmarrje e vështirë dhe e ngadalshme
- b) Mundësi për të marrë frymë vetëm në pozicion ndenjur ose gjysëm ndenjur
- c) Thellim i frymëmarrjes
- d) Frymëmarrje e shpejtë dhe e cekët

25. Matja e pulsit apikalo-radial realizohet nga:

- a) 1 infermiere
- b) 2 infermiere
- c) 3 infermiere
- d) Vetë pacienti arrin ta bëjë këtë matje

26. Parandalimi parësor konsiston në:

- a) Ndërmarrjen e masave parandaluese, para momentit të “instalimit” të sëmundjes
- b) Diagnostikimin dhe trajtimin e hershëm të sëmundjeve

- c) Trajtimin sa më të plotë të kuadrit klinik të sëmundjes, në mënyrë që të shmangen komplikacionet
- d) Këshillimin e pacientëve

27. Parandalimi dytësor konsiston në:

- a) Masa të përgjithshme edukimi
- b) Masa specifike imunizimi
- c) Në diagnostikimin dhe trajtimin e hershëm të sëmundjeve, që sëmundjet të identifikohen në fazën subklinike, pra nuk janë shfaqur akoma simptomat
- d) Ndërmarrja e masave parandaluese para momentit të instalimit të sëmundjes

28. Parandalimi terciar synon:

- a) trajtimin sa më të plotë të kuadrit klinik të sëmundjes, në mënyrë që të shmangen komplikacionet, kronicizimi apo vdekja e të sëmurit.
- b) Ndërmarrjen e masave parandaluese para momentit të instalimit të sëmundjes
- c) Ekzaminimet
- d) Testet diagnostikuese

29. Stadi i parë i sëmundjes është:

- a) Pranimi i rolit të sëmurë
- b) Kontaktimi me kujdesin mjekësor
- c) Përjetimi i simptomave: pacienti është i vetëdijshëm se diçka nuk po shkon mirë, ai kupton një kufizim në funksion, por nuk dyshon për një diagnozë specifike.
- d) Roli i varur i pacientit

30. Stadi i dytë i sëmundjes është:

- a) Kontakti me kujdesin mjekësor
- b) Përjetimi i simptomave
- c) Pranimi i rolit të sëmurë: nëse simptomat vazhdojnë ose bëhen më të ashpra, pacienti pranon rolin si i sëmurë.
- d) Shërimi dhe rehabilitimi

31. Stadi i tretë i sëmundjes është:

- a) Kontakti me kujdesin mjekësor, nëse simptomat janë të qëndrueshme nga terapia mjekësore në shtëpi, sëmundja bëhet më ashpër dhe kërkon ndërhyrje urgjente
- b) Pranimi i rolit të sëmurë, simptomat vazhdojnë të bëhen më të ashpra, pacienti pranon rolin si i sëmurë
- c) Përjetimi i simptomave
- d) Shërimi dhe rehabilitimi

32. Stadi i katërt i sëmundjes është:

- a) Roli i varur i pacientit, në këtë stad pacienti varet nga profesionistët e kujdesit shëndetësor, për të qetësuar simptomat e sëmundjes
- b) Shërimi dhe rehabilitimi
- c) Kontakti me kujdesin mjekësor
- d) Pranimi i rolit të sëmurë

33. Stadi pestë i sëmundjes:

- a) Roli i varur i pacientit, në këtë stad pacienti varet nga profesionistët e kujdesit shëndetësor, për të qetësuar simptomat e sëmundjes
- b) Shërimi dhe rehabilitimi: stadi final i sjelljeve të sëmundshmërisë; shërimi dhe rehabilitimi mund të arrihen
- c) Kontakti me kujdesin mjekësor
- d) Pranimi i rolit të sëmurë

34. Prevalenca e infeksioneve spitalore është:

- a) Numri i rasteve aktive me infeksione spitalore në popullatën e caktuar të sëmurë, gjatë periudhës së caktuar kohore apo momentin e caktuar
- b) Numri i rasteve të reja me infeksione spitalore gjatë një periudhe kohore të caktuar në një popullatë në risk
- c) Popullata e “shëndoshë” në risk (që bart potencialin për zhvillimin e sëmundjes)
- d) Përcaktimi i periudhës kohore gjatë të cilës zhvillohen rastet e reja të sëmundjes

35. Prevalenca është:

- a) Numri i rasteve të reja të sëmundjes gjatë një periudhe kohore të caktuar në një popullatë në risk për zhvillimin e sëmundjes
- b) Popullata e shëndoshë në risk (që bart potencialin për zhvillimin e sëmundjes)
- c) Periudha kohore gjatë të cilës zhvillohen rastet e reja të sëmundjes në popullatë
- d) Numri i individëve të sëmurë të një popullate në një moment kohor të caktuar

36. Incidenca është:

- a) Numri i rasteve të reja të sëmundjes gjatë një periudhe kohore të caktuar në një popullatë në risk për zhvillimin e sëmundjes
- b) Depistimi i të gjitha rasteve të sëmundjes në popullatë
- c) Rritja e kohëzgjatjes së sëmundjes
- d) Ngarkesa e përgjithshme e sëmundshmërisë

37. Me termin asepsi mjekësore kuptojmë:

- a) Eliminimin e shumicës së mikroorganizmave që janë të pranishme në sipërfaqe apo object
- b) Aktivitete që limitizojnë numrin dhe përhapjen e sporeve, mikroorganizmave në një zonë kryesore. Kjo ndryshe njihet si teknikë e pastër

- c) Dezinfektim i objekteve të ndotura me materiale infective
- d) Eliminimi i mikroorganizmave që janë të pranishëm në sipërfaqe apo objekt.

38. Sterilizimi është:

- a) Dezinfektimi i objekteve të ndotura me materiale infective (pusi, gjaku, etj)
- b) Eliminimi i të gjithë mikroorganizmave (viruseve, fungeve mikroskopike, bakterieve dhe sporeve)
- c) Eliminimi i shumicës së mikroorganizmave që janë të pranishme në sipërfaqe ose objekt
- d) Eliminimi i mikroorganizmave prezente

39. Dezinfektimi është:

- a) Dezinfektimi i objekteve të ndotura me materiale infective (pusi, gjaku, etj)
- b) Eliminimi i të gjithë mikroorganizmave (viruseve, fungeve mikroskopike, bakterieve dhe sporeve)
- c) Eliminimi i shumicës së mikroorganizmave që janë të pranishme në sipërfaqe ose objekt
- d) Eliminimi i mikroorganizmave prezente

40. Dekontaminimi është:

- a) Dezinfektimi i objekteve të ndotura me materiale infective (pusi, gjaku, etj)
- b) Eliminimi i të gjithë mikroorganizmave (viruseve, fungeve mikroskopike, bakterieve dhe sporeve)
- c) Eliminimi i shumicës së mikroorganizmave që janë të pranishme në sipërfaqe ose objekt
- d) Eliminimi i mikroorganizmave prezente

41. Vlera normale e pH-it arterial është:

- a) 7.15-7.25
- b) 7.25-7.35
- c) 7.35-7.45
- d) 7.45-7.55

42. Infeksioni është:

- a) Kontakti i nje bujtesi me nje mikroorganizem patogjen.
- b) Prodhimi i toksinave gjate rritjes bakteriale.
- c) Perhapja e nje agjenti patogjen ne popullate.
- d) Penetrimi dhe shumefishimi i nje mikroorganizmi tek nje bujtes.

43. Antidoti qe duhet dhene ne rast mbidoze te heparines eshte:

- a) Vitamine K.
- b) Sulfati i protamines.
- c) Gjaku i fresket i plote.

- d) Plazma.
- e) Kaliumi.

44. Cili është muskuli me aktivitet frymëmarrës më i rëndësishëm?

- a) Muskujt interkostale eksterne
- b) Diafragma
- c) Rektusi i abdomenit
- d) Muskujt interkostale interne
- e) Sternokleidomastoidi

45. Komplikacioni më i zakonshëm gjatë terapisë me heparinë është

- a) Tromboza.
- b) Embolia.
- c) Okluzioni(ose bllokimi) intestinal.
- d) Hemorragjia.
- e) Varicet.

46. Pulsu arterial që preferohet të palpohet në procedurën e dhënies së ndihmës së shpejtë (BLS) është:

- a) Radiali.
- b) Popliteo.
- c) Brakiali.
- d) Temporal.
- e) Karotidi

47. Cila nga të mëposhtmet nuk konsiderohet si shenjë alarmi në një pacient që paraqitet me dispne?

- a) Anemia
- b) Renie e peshes pa arsye
- c) Diarrea kronike
- d) Disfagia
- e) Fillimi i vonshëm i simptomave me një ecure të shpejtë duke u rënduar

48. Nga çfarë karakterizohet një respiracion i tipit Cheyne-Stokes?

- a) Një pauzë respiratore në inspiracion të thellë
- b) Një respiracion i pakordinuar
- c) Një rritje progresive e frekuencës dhe thellësisë së akteve respiratore të cilat ndjekin një pauzë respiratore
- d) Një bradipne e shprehur
- e) Një takipne e shprehur

49. Mbijetesa e eritrociteve në qarkullim është:

- a) 40 ditë.
- b) 60 ditë.
- c) 120 ditë.
- d) 215 ditë.
- e) 300 ditë.

50. Naloxon është nje medikament:

- a) Antiinflamator josteroid.
- b) Kortizonik.
- c) Antipiretik.
- d) Antagonist i morfines.
- e) Analgjezik

51. Efekti antikoagulant i heparinës

- a) Antagonizohet nga vitamina K.
- b) Është i rritur nga nefropatite shoqeruese.
- c) Është i rritur në rast të hipoalbuminemise.
- d) Mund të shkojë kundër fenomeneve të tolerances.
- e) Mund të shoqërohet nga trombocitopenia e rëndë.

52. C'farë nënkuptohet me abces?

- a) Nje grumbullim i qelbit në kavitetin e riformuar
- b) Një infeksion i kolecistes
- c) Një grumbullim gjaku (hematoma)
- d) Një grumbullim seroz

53. Në komën diabetike fryma ka erë:

- a) Urinoze.
- b) Fekale.
- c) Acetoni.
- d) Alkoolike.
- e) Të bajameve të hidhura.

54. C'farë është iluzioni?

- a) Nje perceptim pa objekt
- b) Nje perceptim i gabuar i një stimuli ndijor të vërtetë
- c) Një perceptim pa karaktere shqisore (ose ndijore)
- d) Një anomali e mendimit

e) Një çrregullim i inteligjences

55. Veprimet e mëposhtme për t'u kryer para marrjes së gjakut janë të gjitha të sakta, përveç?

- a) Të kontrollosh emrin mbi etiketen e tubit të analizës.
- b) Të shtrëngosh zhgutën (ose llastikun) për 5 minuta.
- c) Të gjesh venën.
- d) Të dezinfektosh tërësisht .
- e) Të lash duart.

56. Cili nga propozimet e mëposhtme përcakton më mirë inflamacionin?

- a) Një formë edeme
- b) Kemiotaksi e leukociteve drejt bakterieve
- c) Një formë e proliferimit qelizor patologjik
- d) Një reaksion i mikroqarkullimit indor ndaj një stimuli dëmtues
- e) Modifikimi qelizor i prodhuar nga një stimul dëmtues

57. Kodi deontologjik është:

- a) Një përmbledhje e të gjitha ligjeve civile.
- b) Një dokument personal i çdo profesionisti.
- c) Një dokument që përmban normativat direkte për të rregulluar aktivitetin e një kategorie profesionale.
- d) Një dokument që përmban rregullat e implantimit (apo mbjelljes) së dhëmbëve.

58. Cili është shkaku më i shpeshtë i embolisë pulmonare?

- a) Varicet në zonën e safenes
- b) Tromboflebiti i thellë i gjymtyrëve të poshtme
- c) Tromboza arterioze
- d) Flebiti sipërfaqësor i gjymtyrëve të sipërme
- e) Aneurizma e arteries subklavia

59. Një vlerë e Pa CO₂ barabartë me 70 mmHg tregon

- a) Një alkalozë metabolike.
- b) Hipokapni.
- c) Hipoksemi.
- d) Normokapni.
- e) Hiperkapni

60. Vlera normale e hematokritit përfshihet midis:

- a) 20% dhe 30%.
- b) 10% dhe 20%.

- c) 40% dhe 50%.
- d) D)60% dhe 70%.

61. Në rast mbidoze opioidi, antidoti specifik është

- a) metadoni.
- b) buprenorfina
- c) naloxoni
- d) triamcinoloni.
- e) fenilbutazoni.

62. Rakitismi shkaktohet nga:

- a) nga një mungesë e vitamins D.
- b) nga një mungesë e vitamins E.
- c) nga një deficit i calcitonines.
- d) nga nje mungesë e vitamins A.
- e) nga një mungese e vitamins K.

63. Paraliza e gjysmës së trupit, e majte apo e djathtë quhet:

- a) hemiplegji.
- b) paraplegji.
- c) tetraplegji.
- d) diplegji.
- e) distrofi.

64. Cila është shenja më shumë e lidhur me diagnozën e bronkitit kronik?

- a) kollë e thatë
- b) dispne në sforcim
- c) kollë produktive
- d) dispne në qetësi
- e) gjendja febrile

65. Quhet parangarkesë:

- a) tensioni endoventrikular gjatë sistolave ventrikulare.
- b) mbushja diastolike ventrikulare.
- b) gjendja e kontraktuar e miokardit
- d) gjendja e kontraktuar atriale
- e) zbrazja sistolike ventrikulare

66. Cili prej këtyre mikroorganizmave është shpesh shkaktar infeksionesh nozokomiale?

- a) salmonella typhi

- b) treponema pallidum
- c) pseudomonas aeruginosa
- d) virusi i rubeoles
- e) haemofilus influenzae

67. Tek infeskionet spitalore cili prej agjenteve të mëposhtëm etiologjike është më i shpeshti?

- a) bakteret gram pozitive
- b) viruset
- c) bakteret gram negative
- d) myket dhe protozoaret
- e) parazitizat intestinale

68. Cila është një pergjigje normale e tensionit të gjakut gjatë ushtrimit aerobik?

- a) si tensioni sistolik dhe ai diastolik rriten në mënyrë proporcionale me shtimin e ngarkesës së punës
- b) tensioni sistolik rritet dhe tensioni diastolik ulet
- c) tensioni i gjakut sistolik rritet në mënyrë proporcionale me shtimin e ngarkesës së punës ndërsa tensioni diastolik ulet lehtësisht ose mbetet i pandryshuar
- d) si tensioni sistolik dhe ai diastolik ulen në pjesën e parë të ushtrimit dhe me pas rriten në mënyrë proporcionale me rritjen e intensitetit të ushtrimit
- e) tensioni sistolik dhe ai diastolik nuk ndryshojnë

69. Për përgatitjen e pacientit për ndërhyrje kirurgjikale NUK është e nevojshme

- a) të hiqen papastërtitë e lëkures përpara përgatitjes antiseptike.
- b) të bëhet përgatitja antiseptike e lëkures.
- c) dushi antiseptik një natë me parë
- d) nëse është e nevojshme të bëhet depilimi përpara ndërhyrjes
- e) të ushqehet pacienti në 6 orët para ndërhyrjes

70. Cila prej vaksinave të mëposhtme është e detyrueshme?

- a) Antigrip
- b) Antimeningokok
- c) Antihepatit B
- d) Antihepatit A
- e) Anti ekinokok

71. Një ndërhyrje heqjeje e një faktori risku ambiental mund të klasifikohet si:

- a) parandalim dytësor
- b) parandalim tretësor
- c) parandalim parësor

- d) rehabilitim
- e) terapi onkologjike

72. Pulsu arterial është ritmik nëse:

- a) intervali nga nje pulsime tek tjetri eshte konstant dhe i rregullt
- b) mungon në disa pjesë të matshme me palpacion.
- c) shoqërohet nga dridhje palpatores.
- d) gjendet lehtë
- e) paraqet ekstrasistola

73. Dispnea tek koma diabetike karakterizohet përgjithësisht nga

- a) frymemarrja Biot.
- b) frymemarrja Kussmaul
- c) frymemarrja Cheyne-Stokes.
- d) dispne ortostatike
- e) dispne ne Tredelenburgh

74. Një pacient i prekur nga një infeksion bakterial merr trajtim me antibiotikë intramuskular me bazë Peniciline. Disa minuta pas injeksionit pacienti shfaq një sindromë respiratore akute dhe humbet ndjenjat. Ky reagim ndërmjetesohet nga:

- a) Limfocitet T.
- b) IgG dhe IgM.
- c) IgE
- d) IgG dhe plotësues
- e) IgA

75. Cili prej pohimeve të mëposhtme mbi anurinë është i saktë?

- a) është paafesia për të mbajtur urinen
- b) është humbja e vullnetshme e urines
- c) është humbja e urinës gjatë gjumit
- d) është paafesia për të urinuar gjatë gjumit
- e) është mungesa totale e prodhimit të urines

76. Cila nga masat e mëposhtme nuk përbën një profilaksi specifike?

- a) sterilizimi, dezinfektimi, dizinfestacion (kontrolli i insekteve)
- b) administrimi i vaksinave
- c) administrimi i imunoglobulinave
- d) kemioprofilaksia
- e) skema kombetare e vaksinimit

77. Tuberkulozi pulmonar transmetohet kryesisht:

- a) prej ajrit nëpërmjet sperklave të ekspektoratit.
- b) nëpërmjet objekteve që vijnë në kontakt me subjektet e infektuara.
- c) nëpërmjet ushqimeve dhe pijeve.
- d) prej mikobaktereve prezente në ambient.
- e) Jatrogjenike

78. Në një litër të një tretësire molare të glukozës gjenden:

- a) 4,5 gr glukozë.
- b) 9 gr glukozë.
- c) 18 gr glukozë.
- d) 36 gr glukozë.
- e) 72 gr glukozë.

79. Efekti më i madh i insulinës me veprim të ndërmjetëm të dhënë me rrugë subkutane arrihet pas:

- a) 2-3 oreve.
- b) 6-8 oreve.
- c) 10-16 oreve.
- d) 12-20 oreve.
- e) 18-24 oreve.

80. Kuadri klinik karakteristik i astmës bronkiale nuk përfshin:

- a) dispnë.
- b) hemoftizine.
- c) frymëmarrjen me fishkëllimë.
- d) kollën.
- e) ndjesinë e ngushtimit të krahavorit.

81. Fjala edemë tregon

- a) akumulimin e likidit në kavitetin pleurik.
- b) akumulimin e yndyrës në nënlëkurë.
- c) formimin e embolive të yndyrshme në qarkullimin pulmonar.
- d) akumulimin e lëngut në hapësirën intersticiale.
- e) akumulimin e yndyrës në indin muskular të skeletit.

